



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:203020

Datë: 13.12.2022

Numri i dokumentit: 03746013

**C.nr.1894/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtarja Edije Sezairi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve E.B., C.K., B.V., B.M., D.Sh. të cilët me autorizim i përfaqëson avokat A.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson av B.M. nga Prizreni, me objekt kontesti kompensimin e shujtave ditore, jashtë seancës në kuptim të nenit 398 të LPK-së, më datën 06.12.2022, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve E.B., C.K., B.V., B.M., D.Sh.
- II. YROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditësve për vitin 2020 ti paguaj:

**E.B.** në emër të shujtave ditore për 117 ditë pune, shumë prej 234 (dyqind e tridhjetë e katër) euro, **C.K.** në emër të shujtave ditore për 117 ditë pune, shumë prej 234 (dyqind e tridhjetë e katër) euro, **B.V.** në emër të shujtave ditore për 117 ditë pune, shumë prej 234 (dyqind e tridhjetë e katër) euro, **B.M.** në emër të shujtave ditore për 117 ditë pune, shumë prej 234 (dyqind e tridhjetë e katër) euro, **D.Sh.** në emër të shujtave ditore për 117 ditë pune, shumë prej 234 (dyqind e tridhjetë e katër) euro. Të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

**II. DETYROHET** e paditura që t'ia paguajë paditësve shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 124,00 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Paditësit E.B., C.K., B.V., B.M., D.Sh. përmes të autorizuarit të tyre av. A.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi me datë 13.09.2021, me kërkesë për kompensimin e shujtave ditore për ushqim në punë për vitin 2020, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit.

Në padi, i autorizuari i paditësve ka theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune pranë SH.F.M.U "Emin Duraku" në Prizren, në kuadër të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren, në cilësinë e mësimdhënësit. Po ashtu në referatin e padisë ka cekur se paditësi gjatë vitit 2020 kanë qenë në marrëdhënie pune, andaj në kuptim të nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive

Sektoriale të Arsimit, iu takon e drejta për kompensimin e shujtave ditore, ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia dhe të obligohet e paditura në përmbushjen e detyrimit.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve. Ka theksuar se paditësit nuk kanë ofruar prova që janë anëtare të sindikatës dhe i kanë kaluar procedurat administrative sepse nuk kanë paraqitur kërkesë për kompensim pranë DKA në Prizren, dhe pretendime tjera sikurse në përgjigje në padi, po ashtu ka theksuar se e paditura nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-066.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 dhe nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë SH.F.M.U “Emin Duraku” në Prizren.

Gjykata përmes vërtetimeve të lëshuara nga ana e të paditurës mbi ditët e prezencës në punë, të paditësve E.B., C.K., B.V., B.M., D.Sh. ka vërtetuar se të njëjtit gjatë vitit 2020, kanë qenë prezent në punë për 117 ditë secili.

Vërtetimet e lartcekura, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj meqë këto dokumente janë të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimet e SH.F.M.U “Emin Duraku”, në Prizren, si prova me të cilat vërtetohen faktet lidhur me ditët e prezencës në punë, gjykata ia fali besimin e plotë, e nga të cila vërtetoi faktin se për 177 ditë brenda vitit 2020, paditësit kanë qenë në vendin punës.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr.01/B nr.105 (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të KKAK-së është paraparë se “Të punësuarve (anëtarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditëseve si punëtorë të arsimit t’ia paguaj kompensimin për ushqimin gjatë punës, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës.

Rrjedhimisht ditët e punës për paditëset, të vërtetuara nga vet punëdhënësi, për secilën paditëse nga 117 ditë pune për vitin 2020, gjykata i ka shumëzuar me shumën prej 2 euro të parapara si në nenin 54 paragrafi 1 të KKAK-së, duke u njohur shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësve është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenit 449, 452 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësve t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë 104.00 € dhe në emër të taksës për padi 20.00 € bazuar në tarifën e OAK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitën e nenit 398 të LPK-së

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.1894/2021 me datën 06.12.2022**

**B. profesional**  
**Shqipron Sedolli**

**Gjyqtarja**  
**Edije Sezairi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës e Apelit e Kosovës, përmes kësaj gjykate.